

WWW.B360.AL

Rruga "Themistokli Gërmenji", Tel: +355 4 2274552
Pallati Ambasador 1, Fax: +355 4 2274553
Tiranë, Shqipëri E-mail: b360@b360.al

B360

WWW.B360.AL

Shërbime profesionale IT
IT i jashtëm (outsource)
Produksion Media dhe Imazh





WWW.B360.AL

B360 – PARTNERI JUAJ NË TEKNOLOGJI

Herët a vonë, në punën tuaj do t'ju nevojitet ndihmë për sistemet dhe rrjetet kompjuterike, ...dhe kur kjo të ndodh... telefononi B360. Në fakt, ne ju inkurajojmë që telefonatën ta bëni ca më herët, që ne të punojmë së bashku për të futur teknologjitë e kohës duke e bërë biznesin tuaj më eficient, më modern dhe më konkurrues. Rri largpamës, kontakto B360 sot e mos prit ditën kur telashet të trokasin në zyrën tuaj.

SHËRBIME PROFESIONALE IT

B360 është ambicioze të ndihmojë organizatat, kryesisht ato të biznesit, që të përdorin më mirë dhe më thellë teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit. B360 ofron shërbime profesionale me impakt të rëndësishëm që i mundësojnë organizatave të përshpejtojnë futjen dhe integrimin e sistemeve ICT, rritjen e besueshmërisë në to, uljen e kostove të operimit dhe rritjen e produktivitetit.

- Instalim-operim me çelësa në dorë.
- Dizajnimi i sigurisë dhe i backup-it. Planifikimi i "disaster recovery"
- Auditimi i sistemeve IT
- Programim, instalim, adaptim, mirëmbajtje të Aplikimeve
- Konsulencë për strategjinë ICT



SISTEME TË TELEKOMUNIKACIONIT

Objektivi ynë kryesor është të instalojmë rrjete të qëndrueshëm, me funksionalitet të lartë dhe me cilësinë më të lartë të kabllimit. Jo më pak e rëndësishme është estetika e instalimit. Duhet bërë ekspozimi më minimal i mundshëm i kabllave pajisjeve dhe një paraqitje të këndshme për syrin në pjesët ku ekspozimi është i paevitueshëm.

Sistemet e telekomunikimit që B360 instalon, konfiguron dhe mirëmban janë:

- Integrim Data -Voice. Centrale telefonik PABX
- Sistem kamerash (web-kamera, kamera sigurie, ekrane monitorimi)
- Sisteme sigurie të integruara (alarm zjarri dhe vjed hjeje, survejim me kamera, kontroll të hyrjes, etj.)
- Kabllim në rrjete bakri dhe fibrash optike
- Linja telefonike, DSL dhe sinjali televiziv
- Rak dhe panele fishash Data / Voice
- Dezenjim dhe integrim infrastrukture për dhomat IT

PRODUKSION MEDIA / IMAZH

Çfarëdo kërkesë për marketing apo training të ketë organizata juaj, nëse kjo kërkesë është e lidhur me video, multimedia apo publikim, B360 ka një zgjidhje për ju. Në bashkëpunim me partnerë me shumë eksperiencë në produksione video-audio, B360 ofron një rang të gjerë prodhimesh me porosi sikurse janë:

- Spote publicitare për TV & Radio. Video për publikim në Web
- Dizenjim i faqes Web
- Dizenjim logo, kartëvizitë, fletë palosje, menu, poster, ftesë, broshurë, etj.
- Dokumentarë
- CD dhe DVD interaktive
- Guida zanore dhe regjistrime zanore





HELP!

IT I JASHTËM (OUTSOURCE)

Qëllimi parësor i B360 është që ajo të behet një shtojcë e vogël në organizatën tuaj, por që ju ofron vlerën e shërbimit që do të prodhonte për ju një sektor i tërë IT i punësuar prej jush. B360 operon ditë pas dite sistemet tuaja IT. Ky shërbim personalizohet për çdo klient. Paketa e shërbimeve outsource që ofron B360 përfshin:

- Programim dhe mirëmbajtje aplikimesh
- Desktop support (blerje, instalim, lëvizje, ndryshim) i sistemeve
- Shërbimi Kërko-ndihmë (Helpdesk)
- Sisteme të rikuperimit nga avaritë e rënda
- Mbrojtja e sistemeve IT
- Operimi i rrjetave të telekomunikacionit
- Dizajnimi dhe zhvillimi i faqeve Web

INSTALIM-OPERIM ME ÇELËSA NË DORË.

B360 ofron zgjidhje të plotë me çelësa në dorë për instalimin e rrjeteve, sistemeve të komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave, posteve të punës, aplikimeve individuale apo në grup, sigurisë, etj. Ne mund të dizenojmë, prokurojmë, konfigurojmë dhe vëmë në zbatim projektin tuaj IT të ardhshëm, duke ju kursyer kohën dhe burimet njerëzore dhe financiare.

AUDITIMI I SISTEMEVE IT

Një numër i madh i manaxherëve të biznesit nuk e kuptojnë në thellësi infrastrukturën IT të instaluar në bizneset e tyre. B360 u siguron atyre një analizë se çfarë sistemesh kanë, si po punojnë këto sisteme dhe ku duhet ndërhyrë për përmirësim.

Ne vlerësojmë procedurat aktuale të IT për të parë nëse i përgjigjen nevojave të momentit të organizatës por edhe të strategjisë së rritjes së biznesit.

PROGRAMIM, INSTALIM DHE MIRËMBAJTJE TË APLIKIMEVE

Një skuadër e përgatitur për dizenjim dhe programim të software analizon thellësisht kërkesat që duhet të plotësoj aplikimi, përgatit arkitekturën, zhvillon dhe teston programin dhe në fund e zbaton atë.

Aty ku zgjidhjet Saas/ Hosted sjellin avantazhe të rëndësishme për organizatën, B360 mund të udhëheq zgjedhjen e aplikimit më të përshtatshëm dhe të ofroj suport për zbatimin e aplikimit.

PLANIFIKIMI I "DISASTER RECOVERY"

Çasti i një avarie të rëndë nuk është momenti i duhur për të ndërtuar strategjinë e rikuperimit. B360 ju asiston për të ndërtuar një plan veprimi që ti kthej sistemet në punë në një kohë fare të shkurtër me humbje minimale të të dhënave.

BACKUP

Ne punojmë me klientët për të vendosur sisteme dhe procedura Backup për tu mbrojtur nga humbja apo korrupsioni i të dhënave.

DIZENJIM I SIGURISË.

Siguria e sistemeve dhe informacionit është një shqetësim dominues për të gjitha organizatat të cilat e përdorin shumë Internetin dhe postën elektronike në punën e përditshme. B360 ofron zgjidhje të sigurisë të avancuara të cilat përfshijnë firewall, anti-virus, anti-spam të kombinuara këto me procedura dhe metodologji pune adekuate.

SHËRBIMI HELPDESK (KËRKO-NDIHMË)

Përmes Helpdeskut, B360 asiston klientin për të zgjidhur sa më shpejt, mundësisht në kohë reale, një problem të çastit që pengon mbarëvajtjen e punës së momentit. B360 përdor teknologji të avancuara të asistencës në distancë për zgjidhjen imediate të shumicës së problemeve që lindin me kompjuterat, serverat, pajisjet aktive të rrjetit dhe aplikimeve në desktop.

KONSULENCË PËR STRATEGJINË ICT

Mënyra më e lehtë për të evidentuar shpenzimet IT është planifikimi për të ardhmen. Duke analizuar sistemet tuaja dhe duke kuptuar rritjen e biznesit tuaj B360 mund të hartoj rrugën ku do të zhvillohen rrjeti dhe aplikimet kompjuterike. Duke e ndjekur këtë rrugë, organizata do të arrijë një efikasitet më të madhe të punëve si edhe rritje të jetëgjatësisë së pajisjeve të tyre.

DESKTOP SUPPORT

Stafi i B360 ju ofron suport për gjithë ciklin e jetës së një sistemi kompjuterik, që nga momenti i blerjes deri në atë eleminimit. Shërbimet e suportit janë të përshtatura për mjedisin tuaj të biznesit.

Do të lëvizni zyrën? Do të instaloni një sistem të ri operimi? Do të transferoni dhe konvertoni të dhënat tuaja? Do zgjidhni laptopin më të përshtatshëm për stilin e punës tuaj? Do të ndërtoni një strategji për digitalizimin e një procesi deri tani manual? B360 mund ti bëjë të gjitha këto për ju dhe për më tepër trajnon përdoruesit për çdo ndryshim të bërë.

OPERIMI I RRJETAVE TË TELEKOMUNIKACIONIT

Sistemet e rrjetave kompjuterike po bëhen më komplekse nga viti në vit. Mund të jetë më e dobishme ta delegoni instalimin apo mirëmbajtjen e tyre tek B360. Në një çmim të vetëm ju do të përfitonit planifikimin e pjesës hardware dhe software të rrjetit, integrimin e sistemeve të rrjetit, mirëmbajtje, supervizim dhe mbrojtje nga hakersat.

DIZENJIMI DHE ZHVILLIMI I FAQEVE WEB

Kur flasim për një zgjidhje Web, B360 ju siguron një zgjidhje komplete me çelësa në dorë: dizenjim grafik të faqes Web, asistencë në krijimin e përmbajtjes së faqes, programimi i faqes dhe hostimin/ngarkimin në internet.

Cilado qoftë madhësia dhe kompleksiteti e faqes tuaj Web, B360 do t'ju grantojë një zgjidhje shumë profesionale. Që nga momenti që faqja juaj Web është lançuar, B360 mundëson ndryshimet dhe përmirësimet e saj.

B360 shpk

**Rruga Themistokli Gërmenji”
Pallati Ambasador
Tiranë, Shqipëri**

**Tel: +355 4 2274552
Fax: +355 4 2274553
E-mail: b360@b360.al**

**Për të patur një informacion sa më të plotë dhe të
përditësuar për shërbimet tona ju lutemi të vizitoni
faqen tone në Internet www.b360.al**

